



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

---

**PLANI VJETOR I PUNËS PËR VITIN 2023**

**NË DHOMEN E POSAÇME TË GJYKATËS SUPREME TË KOSOVËS NË  
LIDHJE ME AGJENCINË KOSOVARE TË PRIVATIZIMIT**

Ky plan paraqet objektivat kryesore , prioritetet dhe fushëveprimin e aktivitetit të DHPGJS-së për vitin 2023.

Ky plan është në pajtueshmëri me qëllimet dhe planet e DHPGJS-së të përcaktuara edhe brenda kornizës ligjore si dhe kapaciteteve të njerëzore të brendshme e me të cilat disponon kjo Gjykatë.

Gjithashtu ky plan do të shërbej si udhërrëfyes dhe matës në përmbushjen e misionit të DHPGJS-së për vitin 2023.

**Objektivat**

DHPGJS-ja aktualisht ka 13 gjyqtarë prej tyre 10 janë në shkallë të parë dhe Kolegji i Apelit në përbërje prej 03 gjyqtarëve .

DHPGJS-ja në Kolegjiun e gjyqtarëve të mbajtur me datën **20/01/2023** si objektiv të vetin ka caktuar shqyrtimin e lendeve të natyrës pronësore të privatizimit dhe statusore që datojnë nga më

e vjetra që do të jetë vazhdimësi edhe për vitin 2023 “ të emërtuara si Lëndë të vjetra” si dhe lëndët e kthyera në rigjykim.

Lëndë të vjetra konsiderohen paditë e parashtruara deri më 31 dhjetor 2014. Në këtë grup përfshihen edhe lëndët që në DHPGJS vijnë nga Gjykatat e rregullta deri më 31 dhjetor 2021 por që në Gjykatat e rregullta janë parashtruar par vitit 2014 si dhe lëndët e kthyera në rigjykim.

Kolegji i Apelit nuk ka lëndë të evidentuara në grupin e lëndëve të vjetra gjegjësisht të parashtruara para vitit 2021.

Zyra e regjistrimit tashmë ka vendosur referenca duke saktësuar datën e parashtrimit të padisë së parë në Gjykatat e rregullta për të gjitha lëndët e referuara në DHPGJS-së në tabelën lëndët e vjetra dhe të kthyera në rigjykim në Exel .

Tabela në Exel e këtyre lëndëve është dërguar tek të gjithë gjyqtarët dhe të gjithë janë të informuar me cilat lëndë janë të ngarkuar. Në të njëjtën mënyrë do të veprohet edhe me lëndët e kthyera në rigjykim si dhe prurjet nga gjykatat e rregullta e të cilat janë parashtruar para 31 dhjetor 2014.

Gjithashtu Zyra e regjistrimit tashmë ka identifikuar lëndët e natyrës së njëjtë dhe ka informuar gjyqtarët dhe mbikëqyrësin me qëllim të krijimit të një Kolegji sipas nenit 9. 4 të Ligjit nr. 06/l-086.

Gjithashtu është planifikuar dhe të gjithë gjyqtarët janë zotuar se në këtë vit do të merren ekskluzivisht me lëndë tashmë të identifikuara si të vjetra, pa marr parasysh kohën dhe normën e parashikuar.

Çdo gjyqtarë do të pajiset me një raport me numrin e saktë të lëndëve të kësaj natyre nga zyra e regjistrimit për tërë periudhën një vjeçare.

Seancat dëgjimore do të paraqiten në –Share- ku është tabela e seancave 2023, si dhe do të informohet krye regjistruësja bashkë me përkthyesin kur është i nevojshëm. Kjo bëhet me qëllim të njoftimit sa më të shpejt dhe me kohë të gjithë aktorëve që janë pjesë e seancës.



Pas përfundimit të lëndëve tashmë të evidentuar si lëndë të vjetra, krye regjistruësja në fund të çdo muaj paraqet raport për lëndët e përfunduara si të vjetra për çdo gjyqtarë veç e veç. Raporti dërgohet në adresë të Mbikëqyrësit, Kryetarit dhe KGJK-së.

Për shkak të kompleksitetit ( natyra juridike pronësore të privatizimit dhe statusore) të këtyre lëndëve konsiderojmë se duhet mbajtur edhe Seancë dëgjimore.

Vlen të theksohet që të gjitha lëndët evidentuar si të vjetra sipas nenit 4.9 të Ligjit, pronësore dhe të privatizimit duhet krijuar Kolegj prej tre gjyqtarëve. Prandaj edhe vendimmarrja do të merr kohë më të gjatë.

Ligji i Dhomës parasheh që në të gjitha rastet, Kolegji duhet të përpiket që çështjet në fjalë t'i përfundojë me një Seancë Dëgjimore. Prandaj duke u bazuar edhe nga periudha e fundit e këtij viti, konsiderojmë se mund të mbahen deri në 400 seanca dëgjimore (+ - 10%).

Duhet theksuar se në këtë plan duhet të përfshihen edhe masat e sigurisë të cilat kanë prioritet në trajtim për shkak të urgjencës si dhe paditë për pengim posedimi që mund të paraqiten në vitin vijues.

Sipas pritshmërive tona lidhur me kërkesat dhe paditë e tilla bazuar në vitin paraprak do të mund të arrijnë numrin deri në 30 lëndë. Ato duhet të trajtohen menjëherë pa marrë parasysh kohën e parashtrimit.

Aktualisht në DHPGJS-së evidentohen 12 lëndë nga natyra juridike, Lista e punëtorëve apo 20 %, prej tyre për vitin 2021 janë gjithsejtë 05 lëndë ndërsa për vitin 2022 janë 07 lëndë të cilat sipas ligjit dhe praktikës së DHPGHS-së kanë prioritet në raport me lëndët e tjera. Në këtë grup të lëndëve të natyrës së tillë evidentohen gjithsejtë 613 ankes.

Për vitin 2023 DHPGJS-ja planifikon që në shkallë të parë të zgjidhen të gjitha lëndët nga lista e punëtorëve të evidentuara për vitin **2021**.

Gjithashtu për vitin vijues planifikohet të përfundojnë edhe lëndët apo kërkesa për mbylljen /përfundimin e një procedure të likuidimit ndaj një Ndërmarrje shoqërore.

Prurjet për këtë vit për Lendet e natyrës së tillë do të jenë më të mëdha ,ato kanë një rendësi veçantë për procesin e likuidimit . Andaj do të trajtohen sa më shpejtë që është e mundur pa marrë parasysh kohën e parashtrimit të tyre.

Gjithashtu të gjitha Aktgjykimet /Aktvendimet do të publikohen në faqen zyrtare të Gjykatës Supreme.

Gjyqtari mbikëqyrës Ilmi Bajrami